



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:107303

Datë: 25.02.2025

Numri i dokumentit: 06894825

C.nr.2656/21

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve F.K dhe dhe F.V., që të dy nga ..., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit A.Rr., avokat nga ..., kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson S.L., zyrtare ligjore pran të paditurës, në çështjen juridike kontestimore për anulimin e vendimit, si dhe kompensimin diferencës në pagë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik kryesor me datë 03.02.2025, në prezencë të autorizuarit të paditësve, si dhe përfaqësueses së të paditurës, me datë 25.02.2025, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësve F.K. dhe F.V., me të cilën kanë kërkuar që të: “ANULOHET si i kundërligjshëm vendimi i Senatit të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me seli në Prishtinë, me nr. protokoli 497, i datës 12.04.2021, dhe të VËRTETOHET se e paditura ua ka shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës paditësve për shkak mos avancimit në pozitën e Profesorit asistentë për lëndët Kirurgji, Infermiera kirurgjike dhe onkologji, Kirurgji traumatologjike, Ndihma e parë sipas Konkursit nr.1/173, të datës 27.04.2018, si dhe TË DETYROHET e paditura Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me seli në Prishtinë, që në emër të diferencës në pagë në mes të pozitës së punës Asistent dhe Profesor asistent, për periudhën kohore nga data 01.12.2018 e deri me 24.10.2023, paditësve F.K. dhe F.V., secilit t’ua paguaj pagat neto në shumën totale prej nga 18,604.09 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit që nga data 01.06.2021 e tutje deri në pagesën definitive, kontributin pensional të punëdhënësit dhe të punësuarit në shumën prej nga 2,175.92 Euro, si dhe tatimin në paga të mbajtur në burim në llogarinë e ATK-së, në shumën prej nga 2,067.12 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit në padi, precizim të padisë dhe gjatë seancave gjyqësore pranë kësaj gjykate përmes të autorizuarit të tyre, kanë kërkuar anulimin e vendimit të të paditurës-Senatit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me nr. prot.497 të datës 12.04.2021 dhe kompensim të diferencës në pagë në mes të pozitës së punës Asistent dhe Profesor Asistent.

Në referatin e padisë ka theksuar se e paditura Universiteti i Prishtinës konform Ligjit Nr.04/L-037 të Arsimit të Lartë, Statutit të Universitetit dhe nevojës së Fakultetit të Mjekësisë, përmes Konkursit për zgjedhjen e personelit akademik të datës 27.04.2018 me nr.prot. 1/173, ndër të tjera ka shpallë konkurs për dy pozita të lira për mësimdhënës për lëndët: Kirurgji, Infermieri Kirurgjike dhe Onkologji, Kirurgji traumatologjike, Ndihma e parë. (pozita 48 dhe 49 e konkursit). Pas aplikimit të kandidatëve në lidhje me pozitat përkatëse të konkursit, komisioni recensues (vlerësues) pas shqyrtimit të dokumentacionit të të gjithë kandidatëve, lidhur me pozitën 48 për një mësimdhënës në lëndën Kirurgji, Infermieri kirurgjike dhe onkologji, Kirurgji traumatologjike, Ndihma e parë, përmes Raportit nr.6084 të datës 18.06.2018 ka propozuar për emërim në këtë pozitë kandidatin Dr.F.K. dhe lidhur me pozitën 49 për një mësimdhënës në lëndën Kirurgji, Infermieri kirurgjike dhe onkologji, Kirurgji traumatologjike, Ndihma e parë dhe përmes Raportit nr.5591 të datës 13.06.2018 ka propozuar për emërim në këtë pozitë kandidatin Dr.sci.F.V.-paditësin e dytë. Komisioni i Ankesave, me Raportin nr.724 të datës 24.07.07.2018, pas shqyrtimit të ankesave të kandidatëve të pakënaqur lidhur me propozimet për emërim pozitën 48 dhe 49, ka konstatuar se kandidatet e propozuar për emërim në pozitat 48 dhe 49 i plotësojnë të gjitha kriteret e nevojshme të parapara me Statut dhe Rregulloren e Universitetit të Prishtinës për avancim. Duke marrë për bazë raportin e Komisionit të Ankesave, Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë ka refuzuar ankesat e kandidateve lidhur me raportet e komisioneve recensuese, dhe në të njëjtën kohë ka miratuar raportin e komisionit recensues nr.4084 të datës 18.06.2018 për pozitën 48 dhe nr.4084 të datës 18.06.2018 për pozitën 49. Fakulteti i Mjekësisë përmes shkresës nr.8127 të datës 06.09.2018 ka njoftuar Rektorin dhe Senatit të Universitetit të Prishtinës, lidhur me miratimin e të gjitha raporteve të komisioneve vlerësuese (recensuese) nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, përfshirë këtu edhe raportet për pozitën 48 dhe 49. E paditura me Vendimin nr.3/194 të datës 17.10.2018 ka kthyer në rishqyrtim në Këshillin e Fakultetit të Mjekësisë lëndët e kandidatëve Z.H, T.P., L.N, H.Q, H.A, N.S, F.K., F.V., N.Z, H.R, I.T, P.S. Fakulteti i Mjekësisë duke vepruar sipas Vendimit të të Paditurës nr.3/194 të datës 17.10.2018, ka bërë rishqyrtimin e të gjitha propozimeve dhe përmes shkresës nr.10087 të datës 23.10.2018, ka njoftuar Rektorin dhe Senatit të Paditurës se Këshilli i Fakultetit ka rishqyrtuar secilën lëndë veç e veç dhe ka konstatuar se janë respektuar kriteret bazë për përzgjedhjen e kandidatëve sipas konkursit dhe akteve ligjore në fuqi, andaj i propozon Senatit të Universitetit zgjedhjen e kandidatëve të lartcekur në pozitat përkatëse. Ka shtuar se që nga data 23.10.2018 e paditura nuk kishte marrë asnjë vendim lidhur me avancimin ose mos avancimin e paditësve në pozitën 48 dhe 49 të Konkursit, dhe për të njëjtit procesi i avancimit kishte mbetur pezull, me status të pa definuar sepse avancimi për këto dy pozita nuk është futur në rend dite asnjëherë në mbledhjen e Senatit të të paditurës. Paditësi i parë dhe i dytë, në cilësi të kandidatëve për avancim në këto pozita disa herë përmes shkresave të ndryshme i janë drejtuar Rektorit të UP-së me kërkesë që

çështjen e tyre të avancimit ta fusin në rend dite dhe ta hedhin në votim në mbledhjet e radhës së Senatit, mirëpo të gjitha shkresat dhe kërkesat e dërguara në këtë drejtim kanë hasur në vesh të shurdhër. Shton se një rrethanë e cila ka ndikuar hedhurazi deri te ky pezullim i procedurës (edhe pse nuk është marrë asnjë vendim për pezullim) është paraqitja e kallëzimit penal të datës 11.09.2018 nga kandidatet e pakënaqur, ne drejtim të dekanes së Fakultetit të Mjekësisë dhe anëtarëve të komisionit rencensues (znj.M.K) i cili kallëzim penal me Aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PPN.I.nr.247/2018 të datës 28.09.2020 është hedhur poshtë dhe procedura penale është pushuar, për shkak se nuk ka ekzistuar as dyshimi i arsyeshëm se personat e dyshuar kanë kryer veprat penale për të cilat është paraqitur kallëzimi penal. Pas krijimit të rrethanave të reja dhe pushimit të procedurës penale nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, paditësit përmes përfaqësuesit të tyre, me datë 19.10.2020 i janë drejtuar përsëri të paditurës me një shkresë zyrtare, përmes së cilës kanë kërkuar që të futet në rend dite propozimi i Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë lidhur me pozitën 48 dhe 49. Me vënien në dijeni rreth vendimit të Prokurorisë, thekson se e paditura kishte thirrur mbledhjen e III-të të Senatit të UP për datën 22.10.2020, në të cilën ishin paraparë njëmbëdhjetë (11) pika të rendit të ditës, ndërsa në pikën e nëntë (9) të saj ishte paraparë shqyrtimi dhe vendosja lidhur me lëndët e Kirurgjisë, pozita 48 dhe 49 sipas konkursit të datës 27.04.2018 (pas vendimit të Prokurorisë). Në lidhje me këtë ishin njoftuar edhe menaxhmenti i senatoreve përmes komunikimi elektronik emaili i datës 19.10.2020 ne ora 10:24 i dërguar nga Sekretari i UP-së z.Kelmendi. Thekson më tej se pika e nëntë e rendit të ditës e paraparë për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me lëndët e Kirurgjise, pozita 48 dhe 49 sipas konkursit të datës 27.04.2018 (pas vendimit të Prokurorisë) ishte hequr në tërësi dhe në vend të saj në rend dite është vendosur një çështje krejtësisht tjetër. Duke marrë parasysh këto rrethana kandidatet këtu paditësit përmes shkresës se datës 21.01.2021 i janë drejtuar Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtrësia si organ i shkallës së dytë, me kërkesë për nxjerrjen e vendimit e lidhur me avancimin e tyre për pozitën 48 dhe 49 të Konkursit, mirëpo të njëjtit nuk kanë marrë asnjë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë. Thekson se duke marrë parasysh këtë situatë në të cilën e paditura nuk nxirrte asnjë vendim me shkrim ne lidhje me çështjen e avancimit të paditësve për pozitën e lartcekura, të njëjtit përmes përfaqësuesit të tyre me datë 26.01.2021 kanë paraqitur ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut Neni 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetues së Republikës së Kosovës, të ndërlydhura edhe me nenin 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ankesë përmes njoftimit të datës 24.02.2021 është konsideruar si e pranueshme. Po ashtu pas kësaj paditësit përmes shkresës se datës 23.02.2021 i janë drejtuar Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtrësia me një kërkesë të përsëritur për nxjerrjen e vendimit në lidhje me avancimin e kandidateve për pozitën 48 dhe 49 të Konkursit mirëpo përsëri nuk është marrë asnjë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë, e as në lidhje me kërkesat tjera të parashtruara më herët. Te njëjtit po ashtu me datë 24.02.2020 i kanë dërguar një njoftim përmes postës elektronike (email) në drejtim të drejtuesve të UP-se përfshirë Rektorin, Pro Rektoret dhe Sekretarin, në të cilin e-mail kanë bashkangjitur kërkesën e fundit të dërguar në drejtim të Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtrësia, por përsëri nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Andaj duke marrë parasysh këtë heshtje të të paditurës për mos nxjerrje të vendimit paditësit kanë paraqitur padi në gjykatë për nxjerrjen e vendimit. Ndërkohë shton se pas një kohe të gjatë pothuajse 3 vjeçare pas përpjekjeve të shumta Senati i UP-së më në fund ka nxjerrë Vendimin me nr. prot.497 te datës 12.04.2021, përmes të cilit konsideron se Konkursi nr.1/173 i datës 27.04.2018 është përfunduar

në kontekst të afatit të paraparë me Nenin 14 pika 4 dhe 6 të Rregullores nr.456 të datës 02.03.2018. Padiësit duke qenë të pakënaqur me Vendimin Nr.prot.497 të datës 12.04.2021, brenda afatit ligjor me datë 21.04.2021 paraqitën ankesë pranë Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtrësira, mirëpo nuk morën asnjëherë përgjigje në lidhje me ankesën e paraqitur edhe pse në lidhje me këtë çështje është dashur të vendoset në afat prej tridhjetë (30) ditësh në kuptim të nenit 135 të LPP-së. Po ashtu me datë 24.05.2021 kanë paraqitur një kërkesë të përsëritur në drejtim të Komisionit të Senatit me kërkesë që të nxirret një vendim me shkrim në lidhje me ankesën e paraqitur, mirëpo padiësit përsëri nuk morën asnjë përgjigje. Duke pasur parasysh të gjitha këto padiësit kanë theksuar se paraqesin këtë padi për shkak se konsiderojnë se Vendimi i Senatit të UP-së nr.prot.497 i datës 12.04.2021 duhet të anulohet sepse i njëjti përmban ne vete: Shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LLPA), shkelje të dispozitave të së drejtës materiale dhe Shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim theksojnë se vendimi është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPPA sepse i njëjti është hartuar në kundërshtim me këto dispozita, për shkak se i mungojnë elementet e detyrueshme të cilat duhet të përmbajë në kuptim të dispozitës së nenit 47 të LPPA e si pasojë e të cilave i njëjti duhet të anulohet. Po ashtu theksojnë se në arsyetimin e vendimit të senatit i njëjti është mjaftuar të konstatoj se meqenëse afati i rregullt prej 175 ditësh dhe afati plotësues prej 30 ditësh është tejkaluar qysh në fund të vitit 2018, atëherë në kuptim të nenit 14 par.6 të Rregullores nr.465 të datës 02.03.2018, Konkursit nr.1/173 i datës 27.04.2018 është përfunduar, mirëpo nuk kuptohet se çfarë do të thotë “përfundim” në këtë rast dhe po ashtu në arsyetim të vendimit nuk tregohet se çka ka ndikuar deri te kjo vonesë në marrjen e vendimit dhe as arsyet se përse propozimet e Fakultetit të Mjekësisë në lidhje me pozitën në fjalë nuk janë shqyrtuar me kohë nga ana e Senatit. Ka shtuar se rrjedha e afatit prej 175 ditësh është ndalur sepse sipas nenit 85 të LPPA pezullimi i procedurës ndalon dhe rrjedhjen e afatit për të gjitha veprimet procedurale e që në këtë rast procedura është dashur të pezullohet sepse disa kandidat kishin paraqitur kallëzim penal të datës 11.09.2018 në drejtim të dekanes së Fakultetit të Mjekësisë dhe anëtareve të komisionit recensues, dhe deri në marrjen e një vendimi nga Prokuroria procedura është dashur të pezullohet. Shton se duke pas këto për bazë kalimi i afatit të përcaktuar me Rregulloren nr.465 të datës 02.03.2018 nuk është bërë për shkak të veprimeve apo mos veprimeve të padiësve, por për shkak të mos efikasitetit dhe interferimeve nga jashtë. Po ashtu padiësit nuk janë udhëzuar për mjet juridik, të drejtën për të paraqitur ankesë ndaj vendimit të Senatit të UP-se e cila e drejtë garantohet me Nenin 14.par.3 të Rregullores Nr.465 të datës 02.03.2018. Kanë shtuar se Vendimi i të Padiësve është marrë edhe në shkelje të dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (LAL), Statutit të UP-së dhe Rregullores nr.465 të datës 02.03.2018. Sepse neni 173 par.1 i LAL-së thotë: Statuti i një institucioni publik të arsimit të lartë përmban dispozita lidhur me emërimet, mandatet, ngritjen në pozite, disiplinën, suspendimin, shkarkimin, pushimin nga puna apo pensionimin. Neni 173 par.1 i Statutit të UP-së thotë se: Nëse këshilli i njësive akademike edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar. Andaj duke marrë parasysh këto senati është dashur ta fus në rend të ditës propozimin e Fakultetit të Mjekësisë dhe që senatorët me votën e tyre të vendosin për avancimin e kandidateve për këto pozita. Kanë shtuar po ashtu se vendimi paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues në kuptim të dispozitave të Kushtetutës dhe KEDNJ-së siç është trajtimi i pa barabartë dhe diskriminues sepse për të gjitha pozitën e shpallura me Konkurs, procedura ka

përfunduar në tërësi dhe ka marrë një epilog, dhe kandidatet janë avancuar nga Senati i UP-së, në bazë të propozimeve të njësisë akademike, ndërsa vetëm për pozitën 48 dhe 49 të konkursit procedura nuk është përfunduar brenda afateve të caktuara, e që paraqet edhe shkelje të nenit 24 dhe 31 të Kushtetues, në ndërlidhje me nenin 6 dhe 14 të KEDNJ-së. Për këto arsye kanë kërkuar që gjykata të merr aktgjykim dhe ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar dhe atë: për padi 312.00 Euro, për taksë gjyqësore 20.00 Euro, për taksë për masë 20.00 Euro, për ekspertizë financiare 200.00 euro, për ankesë kundër aktvendimit 624.00 euro, për seancë për masë 405.60 Euro, për seancën e datës 20.11.2024 shumë prej 405.60 euro, për seancën e datës 03.02.2025 shumë prej 405.60 euro, për precizimin e kërkesëpadisë 312.00 Euro, për fjalë përfundimtare 312.00 euro, si dhe taksë shtesë 80.00 Euro, apo në total 3,096.80 Euro.

E paditura përmes përgjigjes në padi dhe deklarimeve në seanca gjyqësore si dhe fjalë përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke theksuar se Senati i Universitetit të Prishtinës ka vepruar në harmoni me aktet ligjore: Statutin e UP-së, Rregulloren me nr.456 të datës 02.03.2018 dhe me Ligjin e Punës Nr.03/L-212. Komisioni vlerësues i emëruar për pozitën nr.48 dhe 49. Ka theksuar se Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë në mbledhjen e datës 31.08.2018 kishte shqyrtuar raportet e komisioneve recensuese për zgjidhjen dhe avancimin e kandidateve në thirrjet përkatëse të cilët i kanë plotësuar kushtet konform dispozitave të Statutit të UP-së dhe ka miratuar raportet e komisioneve recensuese të konkursit të shpallur me 24 Prill 2018. Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, në zbatim të nenit 173 pika 1 të Statutit të UP-së i ka propozuar organeve kompetente të UP-së, Senatit të UP-së të vendosin lidhur me këtë çështje që kandidatet F.K.-asistent dhe F.V.-asistent, të avancohen-zgjidhen në thirrjen akademike profesor asistent. Pas ankesave të shumta të kandidateve të cilët kanë aplikuar në pozitën 48 dhe 49 të cilët kanë bërë edhe kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë ndaj anëtarëve të Komisionit Vlerësues, anëtarëve të Komisionit të Ankesave dhe menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë, dhe mos përputhjes së vlerësimeve nga ana e organeve vlerësuese Senati i UP në zbatim të nenit 173 pika 2 dhe 3 dhe neni 177 të Statutit të UP-së dhe akteve ligjore në fuqi për zgjedhjen e personelit akademik në mbledhjen e mbajtur me datë 15.10.2018 pas vlerësimit të raporteve të komisionit vlerësues/recensues, vendimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, dhe pas vlerësimit dhe mendimit të komisionit këshillëdhënës të rektorit, konstaton që lëndët e tyre të kthehen për rishqyrtim edhe njëherë në Këshillin e Fakultetit të Mjekësisë. Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë në zbatim të Vendimit me nr. prot. 3/194, datë 17.10.2018, të Senatit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.10.2018, ka rishqyrtuar lëndët për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik, ka konstatuar gjendjen e raporteve vlerësuese mbështetur në Statutin e UP-së, dhe pas vlerësimit ka sjellë shkresën/raportin me nr. prot. 4/390, datë 23.10.2023, ku tek pika e 7 dhe 8 e shkresës/raportit propozon që paditësit F.K. dhe F.V., të avancohen në thirrjen profesor asistent. Senati duke pasur parasysh se për pozitën e lartë cekura të konkursit disa nga kandidatet kishin ngritur kallëzim penal, ndaj dekanes së fakultetit prof. Dr S.K., ndaj anëtarëve të komisioneve vlerësuese dhe ndaj anëtarëve të komisioneve të ankesave në mbledhjen e senatit të UP datë 15.11.2018, tek pika 4 e rendit të ditës pasi kishte rishqyrtuar rastet e pa përfunduara në Fakultetin e Mjekësisë

kishte trajtuar rastet e kthjera nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, mirëpo nuk i kishte trajtuar dhe shqyrtuar rastet e paditësve F.K. dhe F.V. për pozitën 48 dhe 49. Nga kjo periudhë paditësit F.K. dhe F.V., nuk kishin pranuar ndonjë vendim se janë refuzuar apo zgjedhur me arsyetimin se lënda gjendet në prokurori nga disa kandidat që të cilët kanë parashtruar ankesat për pozitën nr. 48 dhe 49, dhe pas kësaj periudhe Konkursi i datës 27.4.2018 me nr. prot. 1/173, i kishte përfunduar në kontest afati ligjor i përcaktuar sipas nenit 14 pika 4 dhe 6 e Rregullores me nr. prot. 465 dt. 2.3.2018, për procedurat e përzgjedhjes lidhur me emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik në UP. Prokuroria Themelore kishte nxjerr Aktvendimin me numër 247K/2018, datë 28.09.2020, me të cilin kishte hedhur poshtë kallëzimin penal i parashtruar me date 11.09.2018. Shton se Menaxhmenti i UP-së nuk ka pasur mundësi që ta përfshijë kërkesën në fjalë deri në dhënien e datës 12.4.2021, ku pika e 6 e rendit të ditës ishte: Marrja e vendimit për rastet e përfunduara nga konkursi me nr. prot. 1/173 i datës 27.4.2018, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të UP-së. Senati I UP-së lidhur me procesin e zgjedhjes dhe avancimeve akademike të rregulluara me nenin 173 pika 1 dhe neni 176 të Statutit të UP dhe në bazë të veprimeve procedurale të rregulluara me nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe në bazë të kompetencave të shprehura në nenin 48 të Statutit të UP-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.04.2021 merr vendim me të cilin Konkursin e shpallur nga Senati i UP-së, me datë 27.04.2018, nr. 1/173 e ka përfunduar në kontekst të afatit ligjor të paraparë sipas nenit 14 te pikës 4 dhe 6 të Rregullores me nr. 456, dt. 2.3.2018, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP. 2. Në nenin 14, paragrafi 6 të Rregullores me nr. 456, dt. 2.3.2018, është paraparë se në rast se konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 14, atëherë vendet përkatëse të përcaktuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së fakultetit. Prandaj mbi këtë bazë, lëndët të cilat kanë qenë të publikuara me konkursin si në pikën 1 te këtij vendimi dhe të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të trajtohen apo për të cilat nuk është marr një vendim përfundimtar brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 14 të Rregullores me nr. 456, dt. 2.3.2018, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP, të njëjtat mund të rishpallen sipas kërkesës së fakultetit. Tek shtojca 1 e vendimit, lista e lëndëve mësimore nga Konkursi nr. 1/173, dt. 27.04.2018, për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e UP-së të datës 27.04.2018, te cilat nuk janë realizuar, respektivisht nuk janë përmbyllur me një vendim përkatës, janë dy pozita në Fakultetin Juridik, një pozite në Fakultetin Ekonomik, dhe pozita nr. 48 dhe 49 në Fakultetin e Mjekësisë (pozitat në të cilat kanë aplikuar paditësit). Nuk janë vetëm dy pozitat, pozita nr. 48 dhe 49 në Fakultetin e Mjekësisë, të cilat nuk janë përmbyllur për shkak të rrethanave të cekura më lartë por janë edhe pozitat në dy fakultetet e tjera Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik. Ka shtuar se Gjykata me rastin e vendosjes duhet të ketë parasysh respektimin e autonomisë së bartësve të arsimit të lartë. Universiteti i Prishtinës ka të drejtën ekskluzive të garantuar me nenin 13 par.2 pika 2.3 te Ligjit të Arsimit të Lartë ku Neni 13 rregullon Autonominë e bartësve të arsimit të lartë: Bartësit e licencuar të arsimit të lartë kanë autonominë dhe lirinë akademike. 2. Bartësit e licencuar të arsimit të lartë gëzojnë të drejtat nga dispozitat e këtij ligji për të zgjedhur mësimdhënësit dhe personelin tjetër, për të përcaktuar kushte lidhur me pranimin e studentëve, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve, të miratuara nga AKA-ja, prandaj vlerësimi i kushteve të kandidatëve bëhet vetëm nga trupat akademike brenda universitetit. Në bazë të të

gjitha këtyre dhe procedurave të rregullta për zgjedhjen/rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik, kundërshtojnë në tërësi kërkesën për anulimin e vendimit të Senatit të UP-së me nr.prot.497 të datës 12.04.2021 pasi që nuk ka pasur asnjë shkelje procedurale dhe ligjore në rastin e mos emërimit të kandidateve F.K. dhe F.V., andaj duke vlerësuar se nuk ka baze ligjore për anulimin e vendimit e as për kompensimin e diferencës në pagë për paditësit kërkojnë nga gjykata që pas shqyrtimit të padisë të nxjerr aktgjykim me të cilin e refuzon si plotësisht të pa bazuar padinë për anulimin e vendimit të Senatit të UP me nr. prot.497 të datës 12.04.2021 dhe kompensimin e diferencës në pagë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, Gjykata ka administruar provat si në vijim: Konkursi për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës me nr. prot.01/173 dt.24.04.2018; Raporti i Komisionit vlerësues për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik (për Mësimdhënës) nr.6084 dt.18.06.2018; Raporti i Komisionit vlerësues për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik (për Mësimdhënës) nr.5991 dt.13.06.2018; Raporti i shqyrtimit të ankesave të kandidateve për konkursin nr. 1/173 të dt.27.04.2018 UP "Hasan Pristina" - Fakulteti i Mjekësisë; Vendimi Nr. prot.8339 dt. 14.09.2018 për kandidatin Hevdet Quni; Vendim Nr. prot.8346 dt. 14.09.2018 për kandidatin L.L; Vendimi Nr. prot.8347 dt. 14.09.2018 për kandidatin L.V.; Vendimi Nr. prot.8348 dt.14.09.2018 për kandidatin E.F.; 49 sipas konkursit nr. 1/173 te dt.27.04.2018 i dorëzuar me dt. 19.10.2020 nga i autorizuari i paditësve nr. 213; Rendi i ditës lidhur me mbledhjen e mbajtur me dt. 22.10.2020 lëshuar nga e paditura me nr. prot 2/132 dt. 16.10.2020; Kërkesë për nxjerrjen e vendimit lidhur me avancimin e kandidateve për pozitën 48 dhe 19 sipas konkursit nr. 1/173 te dt.27.04.2018 i dorëzuar me dt. 21.01.2021 nga i autorizuari i paditësve; Ankesa drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit nr. 16/21 dt. 26.01.2021 e ushtruar nga i autorizuari i paditësve; Njoftimi për paanshmëri i lëshuar nga Avokati i Popullit nr. 169/21 dt. 24.02.2021; Kërkesë e përsëritur për nxjerrjen e vendimit lidhur me avancimin e kandidateve për pozitën 48 dhe 49 sipas konkursit nr. 1/173 te dt.27.04.2018 e bërë nga i autorizuari i paditësve me dt. 23.02.2021 nr.443; Vendimi Nr. prot.497 dt.12.04.2021 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Ankesë kundër U.P "Hasan Prishtina" Nr. 05 944 dt.21.04.2021 me të cilën është goditur vendimi nr. 497 dt. 12.04.2021; Kërkesa e përsëritur për shqyrtimin e ankesave dhe nxjerrjen e vendimit i dt. 24.05.2021 me nr. 1/231; Konkurs për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës Nr. prot.804 dt. 14.05.2021 nga UP; Ekspertiza financiare e dt.05.12.2024 e përpiluar nga ekspertja financiare E.P.; Vendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.383/19 dt. 19.04.2022; Procesverbalin e mbledhjes së senatit te dt. 15.10.2018; Procesverbalin e mbledhjes së senatit te dt. 12.11.2018; Procesverbalin e mbledhjes së senatit të dt. 12.04.2021.

Gjykata pas vlerësimit të provave, në përputhje me dispozitat nga neni 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet që jepen në vijim të këtij vendimi.

Nga provat e administruara dhe nga deklarimet e palëve ndërgjyqëse gjatë shqyrtimeve gjyqësore, Gjykata vlerësoj se nuk ishte kontestuese fakti se paditësit janë propozuar për emërim në pozitë profesor asistent sipas konkursit nr. prot.01/173 dt.24.04.2018 dhe se ekziston një

vendim i të paditurës-Senatit të Universitetit të Prishtinës, nr.prot.497, i datës 12.04.2021, si autoritet kompetent për emërimin e kandidatëve të përzgjedhur pas votimit në mbledhjet plenare të tij, me të cilin vendim i është përgjigjur kandidatëve se afati kohor brenda të cilit është dashur të përfundoj procedura nga shpallja e konkursit ka mbaruar.

Po ashtu nuk ka qenë kontestues fakti se përmes konkursit në një proces tjetër paditësit F.K. dhe F.V. nga data 24.10.2023, janë avancuar në pozitë Prof. Asistent në Fakultetin e Mjekësisë, për lëndët Kirurgji (MP) (O), Ndihma e parë (MP) (O), Kirurgjia (Praktika klinike) (O), Kirurgji (S) (O), Mjekësi Urgjente (O), Ndihma e parë (STOM), Abdomeni akut (Z), Ndihma e parë (FT) (Z), në bazë të konkursit nr.1/331.

Megjithatë, çështja kontestuese në këtë rast lidhet me vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr.prot.497, i datës 12.04.2021 dhe pasojat juridike që rrjedhin prej tij. Konkretisht, paditësit pretendojnë se vendimi i Senatit është i paligjshëm dhe se, për shkak të mosformalizimit të emërimit të tyre brenda afatit të paraparë, atyre u është shkaktuar dëm material në formën e diferencës së pagës. Në këtë kontekst, ata kërkojnë kompensim financiar për periudhën në të cilën nuk kanë marrë pagën që, sipas tyre, u takonte bazuar në pozitën për të cilën ishin propozuar për emërim.

Në anën tjetër, e paditura – Universiteti i Prishtinës, përmes përfaqësueses së saj juridike, argumenton se afati kohor për finalizimin e procedurës së emërimit ka përfunduar, dhe për këtë arsye, vendimi përfundimtar i Senatit nuk mund të konsiderohet i paligjshëm.

Gjykata analizoj kronologjinë e ngjarjeve deri në nxjerrjen e vendimit të kontestuar dhe vërtetoj faktet si në vijim:

E paditura Universiteti i Prishtinës, përmes Konkursit për zgjedhjen e personelit akademik të datës 27.04.2018 me nr.prot. 1/173, ndër të tjera ka shpallë konkurs për dy pozita të lira për mësimdhënës për lëndët: Kirurgji, Infermieri Kirurgjike dhe Onkologji, Kirurgji traumatologjike, Ndihma e parë. (pozita 48 dhe 49 e konkursit).

Pas aplikimit të kandidatëve në lidhje me pozitat përkatëse të konkursit, komisioni recensues (vlerësues) pas shqyrtimit të dokumentacionit të të gjithë kandidatëve, lidhur me pozitën 48 për një mësimdhënës në lëndën Kirurgji, Infermieri kirurgjike dhe onkologji, Kirurgji traumatologjike, Ndihma e parë, përmes Raportit nr.6084 të datës 18.06.2018 ka propozuar për emërim në këtë pozitë kandidatin Dr.F.K. dhe lidhur me pozitën 49 për një mësimdhënës në lëndën Kirurgji, Infermieri kirurgjike dhe onkologji, Kirurgji traumatologjike, Ndihma e parë, si dhe përmes Raportit nr.5591 të datës 13.06.2018 ka propozuar për emërim në këtë pozitë kandidatin Dr.sci.F.V.-paditësin e dytë.

Komisioni i Ankesave, me Raportin nr.724 të datës 24.07.07.2018, pas shqyrtimit të ankesave të kandidatëve të pakënaqur lidhur me propozimet për emërim për pozitat e lartcekura, ka konstatuar se kandidatet e propozuar i plotësojnë të gjitha kriteret e nevojshme të parapara me Statut dhe Rregulloren e Universitetit të Prishtinës për avancim. Duke marrë për bazë raportin e

Komisionit të Ankesave, Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë ka refuzuar ankesat e kandidateve lidhur me raportet e komisioneve recencuese, dhe në të njëjtën kohë ka miratuar raportin e komisionit recencues nr.4084 të datës 18.06.2018 për pozitën 48 dhe nr.4084 të datës 18.06.2018 për pozitën 49.

Fakulteti i Mjekësisë përmes shkresës nr.8127 të datës 06.09.2018 ka njoftuar Rektorin dhe Senatin e Universitetit të Prishtinës, lidhur me miratimin e të gjitha raporteve të komisioneve vlerësuese (recencuese) nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, përfshirë këtu edhe raportet për pozitën 48 dhe 49.

Me datë 23.10.2018 ishte paraqitur një kallëzim penal nga disa kandidatë të konkursit në drejtim të Dekanes së Fakultetit të Mjekësisë dhe anëtareve të komisionit recencues

E paditura-Senati i Universitetit të Prishtinës me Vendimin nr.3/194 të datës 17.10.2018 ka kthyer në rishqyrtim në Këshillin e Fakultetit të Mjekësisë lëndët e kandidatëve Z.H., T.P., L.A., H.Q., H.A., N.S, F.K., F.V., N.Z, H.R., I.T, P.B.

Fakulteti i Mjekësisë duke vepruar sipas Vendimit të Senatit këtu të paditurës nr.3/194 të datës 17.10.2018, ka bërë rishqyrtimin e të gjitha propozimeve dhe përmes shkresës nr.10087 të datës 23.10.2018, ka njoftuar Rektorin dhe Senatin e të Paditurës se Këshilli i Fakultetit ka rishqyrtuar secilën lëndë veç e veç dhe ka konstatuar se janë respektuar kriteret bazë për përzgjedhjen e kandidatëve sipas konkursit dhe akteve ligjore në fuqi, andaj i ka propozuar Senatit të Universitetit zgjedhjen e kandidatëve të lartcekur në pozitat përkatëse.

Nga data 23.10.2018 paditësit disa here i ishin drejtuar të paditurës-senatit që çështjen e tyre ta fusin në rend dite dhe ta hedhin në votim në mbledhjet e radhës së Senatit, mirëpo e njëjta nuk kishte vepruar deri me datë 12.04.2021 kur ka nxjerrë vendimin e kontestuar.

Me datë 28.09.2020 me Aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PPN.I.nr.247/2018 është hedhur poshtë kallëzimi penal dhe procedura penale është pushuar, për shkak se nuk ka ekzistuar as dyshimi i arsyeshëm se personat e dyshuar kane kryer veprat penale për të cilat është paraqitur kallëzimi penal.

Paditësit përsëri me datë 19.10.2020 i ishin drejtuar të paditurës me një shkresë zyrtare përmes së cilës kanë kërkuar që të futet në rend ditë propozimi i Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë lidhur me pozitën 48 dhe 49.

E paditura me datë 22.10.2020 kishte thirr mbledhjen e III-të të Senatit për datën 22.10.2020 por përsëri nuk kishte vendos në rend dite kërkesën e paditësve.

E paditura përfundimisht me datë 12.04.2021 me vendimin me nr. prot.497 i ishte përgjigjur paditësve dhe përmes këtij vendimi kishte konsideruar Konkursi nr.1/173 i datës 27.04.2018 është përfunduar në kontekst të afatit të paraparë me Nenin 14 pika 4 dhe 6 te Rregullores.

Po ashtu nga ekspertiza financiare e punuar nga ekspertja E.P. e datës 05.12.2024, është dhënë konstatimi se po që se padia e paditësve F.K. dhe F.V. do të ishte e bazuar, secilit prej tyre do ti takonte diferenca në pagë për periudhën prej data 01.12.2018 e deri me datën 24.10.2023 dhe atë paga bruto prej nga 21,759.17 Euro apo neto prej 18,604.09 Euro, kontributi pensional në trust në shumën prej nga 2,175.92 Euro, si dhe tatimi në paga në ATK në shumën prej nga 2,067.12 Euro.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi për arsyet që do të elaborohen më poshtë:

Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-037, në Nenin 13 ka paraparë: *“Bartësit e licencuar të arsimit të lartë kanë autonominë dhe lirinë akademike. 2. Bartësit e licencuar të arsimit të lartë gëzojnë të drejtat nga dispozitat e këtij ligji për të: 2.1. zgjedhur autoritetet drejtuese menaxhuese dhe për të përcaktuar mandatet e tyre; 10 2.2. organizuar strukturat dhe aktivitetet përmes rregullave të tyre, të cilat duhet të jenë në përputhje me këtë ligj dhe me dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të tij, me ligjet e tjera të zbatueshme dhe me statutet e tyre; 2.3. zgjedhur mësimmshënësit dhe personelin tjetër, për të përcaktuar kushte lidhur me pranimin e studentëve, metodat e mësimmshënësies dhe vlerësimin e studentëve, të miratuara nga AKA-ja; 2.4. hartuar dhe zbatuar në mënyrë të pavarur kurrikulet dhe projektet për kërkime shkencore, në këshillim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë; dhe, 2.5. dhënë tituj profesorëve dhe personelit tjetër, në pajtueshmëri me këtë ligj, me ligjin në fuqi për punësim si dhe skemën e aprovuar nga AKA-ja. Këto kritere përcaktohen në statutin e bartësit. 3. Statutet e bartësve të arsimit të lartë përfshijnë dispozita që garantojnë lirinë akademike të personelit mësimmshënës dhe të studentëve, siç përshkruhet tutje në këtë ligj. 4. Mjediset e bartësve të licencuar të arsimit të lartë gëzojnë paprekshmërinë nga organet e rendit publik, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me ligje të veçanta.”.*

Po ashtu Neni 28 i këtij ligji i cili ka paraparë Kushtet e shërbimit të personelit në paragrafin 1 ka përcaktuar: *“Statuti i një institucioni publik të arsimit të lartë përmban dispozita lidhur me emërimet, mandatet, ngritjen në pozitë, disiplinën, suspendimin, shkarkimin, pushimin nga puna apo pensionimin.”*

Me Nenin 148 par.1 të Statutit të UP, është përcaktuar se: *“1. Personeli akademik emërohet nga rektori sipas vendimit të senatit, i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike. 2. Nëse propozimi refuzohet nga senati, ai i kthehet për rishqyrtim këshillit të njësisë akademike. 3. Nëse këshilli i njësisë akademike, edhe pas rishqyrtimit, sjell të njëjtin propozim, senati merr vendim përfundimtar.”.*

Ndërkaq Neni 14. Pika 4 dhe 6 e Rregullores për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP nr.465 të datës 02.03.2018 ka përcaktuar: *“4. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik, duhet të përmbillet me vendime përkatëse të Senatit të UP-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes. 6. Në rast se konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 14, atëherë vendet përkatëse të përcaktuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së fakultetit.”.*

Nga vlerësimi i provave të administruara në seancë gjyqësore dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, Gjykata gjeti se nuk ekziston ndonjë shkelje procedurale ligjore në rastin e nxjerrjes së vendimit nga e paditura.

Gjykata, pas shqyrtimit të provave dhe dispozitave ligjore përkatëse, konstaton se padia e paditësve është e pabazuar. Sipas provave të administruara, Gjykatës i ka rezultuar se e paditura Universiteti i Prishtinës ka ndjekur procedurat e parashikuara për emërimin e personelit akademik, duke përfshirë vlerësimin nga komisioni recensues, shqyrtimin e ankesave nga organet kompetente dhe miratimin e raporteve përfundimtare nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë. Më tej, Fakulteti ka përcjellë vendimet për miratim nga Senati i Universitetit, i cili ka pasur autoritetin përfundimtar për të vendosur lidhur me konkursin në fjalë.

Gjykata gjithashtu vëren se, megjithëse paditësit kanë kërkuar në disa raste përfshirjen e çështjes së tyre në rendin e ditës të mbledhjeve të Senatit, ky organ nuk ka vepruar deri më 12.04.2021, kur ka nxjerrë vendimin me nr. prot. 497, duke konstatuar se konkursi është përmbyllur në kontekstin e afatit të përcaktuar me Nenin 14 pika 4 dhe 6 të Rregullores për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik. Kjo dispozitë përcakton qartë se çdo konkurs për emërim duhet të përfundojë brenda 175 ditëve nga shpallja e tij dhe, në rast të tejkalimit të këtij afati, vendet e paplotësuara mund të rishpallen në konkursin e radhës. Në këtë rast, për shkak të kalimit të afatit ligjor, Gjykata vlerëson se Senati ka qenë në të drejtën e tij që të konsiderojë procedurën si të përfunduar pa miratimin e emërimeve të propozuara.

Për më tepër, kallëzimi penal i ngritur nga disa prej kandidatëve të konkursit ndaj Dekanes dhe anëtarëve të komisionit recensues është hedhur poshtë me aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, pasi nuk është gjetur asnjë bazë për të vërtetuar se është kryer ndonjë vepër penale. Ky fakt forcon qëndrimin se procedurat janë zhvilluar në përputhje me aktet ligjore dhe statutore në fuqi dhe nuk ka pasur shkelje të të drejtave të kandidatëve.

Duke u mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e UP-së dhe Rregulloren për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, Gjykata konstaton se Universiteti i Prishtinës ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe procedurale. Gjykata gjithashtu merr parasysh se e paditura Universiteti i Prishtinës gëzon autonomi në procesin e zgjedhjes së personelit akademik dhe është i detyruar të veprojë sipas rregulloreve të tij të brendshme. Në këtë rast, Senati ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe nuk ka tejkaluar kufijtë ligjorë. Për këtë arsye, pretendimet e paditësve nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe nga këto arsye edhe është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e tyre sa i përket anulimit të vendimit të kontestuar.

Gjykata, duke shqyrtuar pretendimet e paditësve, konstaton se vendimi i kontestuar është marrë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe nuk përmban elemente të paligjshmërisë. Për këtë arsye, edhe pretendimi tjetër i paditësve për kompensimin e diferencës në pagë, nga pozita e asistentit në atë të profesorit asistent, është i pabazuar. Gjykata vlerëson se procesi i emërimit të personelit akademik në Universitetin e Prishtinës është i rregulluar qartë nga Statuti i UP-së dhe Rregullorja për Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik, të cilat

përcaktojnë se vendimi përfundimtar i emërimit merret nga Senati i UP-së, pas shqyrtimit dhe propozimit të këshillit të njësisë akademike. Në këtë rast, nuk ka pasur një vendim të Senatit që do të përmbyllte procesin e emërimit të paditësve, çka e bën të pamundur njohjen e të drejtës për kompensim në bazë të pretendimeve të ngritura.

Gjykata më tej vlerëson se, edhe sikur të ishte konstatuar se vendimi i kontestuar ishte i paligjshëm, nuk do të mund të paragjykohej rezultati i procesit të votimit dhe emërimit të paditësve nga Senati i UP-së. Kjo për shkak se aktet juridike në fuqi përcaktojnë qartë se emërimi në pozitat akademike nuk është një e drejtë absolute e kandidatëve, por një proces që varet nga votimi dhe vendimmarrja kolegjiale e organit kompetent në këtë rast Senatit të UP-së. Për pasojë, pretendimi i paditësve për kompensim financiar nuk mund të mbështetet në një të drejtë të sigurt për emërim, por vetëm në supozimin se ata do të ishin zgjedhur në rast se procedura do të përmbyllej ndryshe. Andaj, nga këto arsye edhe kërkesëpapia sa i përket kompensimit të diferencës në pagë, paditësve iu është refuzuar si e pabazuar.

Në shqyrtimin e pretendimeve të paditësve, Gjykata analizoi nëse afati prej 175 ditësh i përcaktuar në Rregulloren për Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik në UP është ndërprerë në kuptim të nenit 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), për shkak të kallëzimit penal të paraqitur nga disa kandidatë më 11.09.2018. Paditësit argumentuan se për shkak të këtij kallëzimi, procedura për përfundimin e konkursit është dashur të pezullohet deri në marrjen e vendimit nga Prokuroria.

Gjykata vëren se, edhe nëse do të pranohej interpretimi i paditësve lidhur me pezullimin e afatit procedural, kjo nuk do të kishte ndikim në rezultatin përfundimtar të çështjes, pasi afati ligjor për përfundimin e konkursit ka skaduar edhe duke llogaritur periudhën e pezullimit. Konkretisht, konkursi është shpallur më 27.04.2018, ndërsa kallëzimi penal është ngritur më 11.09.2018. Prokuroria ka marrë vendim për hedhjen e këtij kallëzimi më 28.09.2020, ndërkohë që e paditura ka nxjerrë vendimin e kontestuar më 12.04.2021. Duke llogaritur kohën e pezullimit të pretenduar, afati maksimal i lejuar për përfundimin e konkursit do të kishte skaduar gjithsesi, duke e bërë të pamundur nxjerrjen e një vendimi ndryshe nga ai që është marrë.

Gjykata gjithashtu thekson se në kontestet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës, shqyrtimi i saj kufizohet në vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kontestuar në përputhje me Ligjin e Punës dhe aktet nënligjore përkatëse të punëdhënësit. Gjykata nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në vlerësimin e procedurave të brendshme të punëdhënësit si organ administrativ, përveç në rastet kur konstatohet një shkelje e qartë e dispozitave ligjore në fuqi. Duke qenë se vendimi i kontestuar është marrë në përputhje me dispozitat rregullative të aplikueshme dhe nuk është konstatuar ndonjë shkelje e procedurës ligjore, rezulton se kërkesëpapia e paditësve është e pabazuar.

Gjykata pati parasysh faktin se siguria juridike është parim themelor që duhet të garantojë parashikueshmëri dhe mbrojtje të të drejtave ligjore për të gjitha palët. Megjithatë një gjë e tillë sigurohet duke përfillur parimin e ligjshmërisë të cilin në këtë rast Gjykata e pati parasysh dhe

nuk gjeti ndonjë shkelje nga ana e të paditurës e as ndonjë bazë ligjore përmes së cilës paditësit do të mund ti realizonin kërkesat e tyre përmes mbrojtjes gjyqësore.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet tjera të palëve paditëse, por të njëjtat i vlerësoj pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestimore.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, për faktin se palët paditëse e kanë humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyq fituese, ka propozuar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.2656/21, datë 25.02.2025

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.